

## Konkluzionet për Rahovecin

9 Shtator 2005

Kohëve të fundit situata në Rahovec është përmirësuar. Të gjitha palët kanë vullnet të mirë që të punojnë në çështjet dhe të krijojnë një shoqëri të hapur dhe tolerante ku të gjithë mund të jetojnë në siguri dhe dinjitet. Të dyja palët janë pajtuar në një kompromis për simbolin e komunës dhe kjo është një shenjë e mirë e bashkëpunimit.

Siguria është përmirësuar në përgjithësi dhe përpjekje të mira janë bërë në punën për kthim në komunë. Është për të ardhur keq që ende nuk ka pasur kthim në qendër të qytetit. Mirëpo nuk është vetëm komuna përgjegjëse për mungesë të rezultateve në kthim. Kthimet janë të varura nga një përzierje komplekse e faktorëve ku përfshihen dëshira për t'u kthyer, siguria, ndihma për rindërtim që është në dispozicion, zgjidhja e kontesteve pronësore dhe një ambient mirëpritës në vendet e kthimit. Përderisa komuna po punon në kthim, të gjitha palët duhet që të bëjnë më shumë, ndërsa përpjekjet për kthimet në qendër duhet të forcohen.

Në përgjithësi duket që ka pasur përparim në sferën e sigurisë fizike. Nuk ka pasur krime të motivuara etnikisht dhe nuk ka pasur kidnapime; komuna është duke nxitur tolerancën dhe mirëpret Serbët e Kosovës. Sidoqoftë liria e lëvizjes është ende e kufizuar, së pari nga friga që kanë Serbët e Kosovës për të rrezikuar dhe e dyta sepse përshtypja që mbizotëron tek serbët tash është që qendra e qytetit vizitohet vetëm sipas nevojës. Serbëve të Kosovës u duhen më shumë stimulime për të vizituar qendrën e qytetit dhe të ftohen më shpesh nga shokët e tyre shqiptarë.

Përfaqësuesit e Serbëve të Kosovës janë të brengosur për qëndrueshmërinë e kthimit dhe besojnë se më shumë njerëz largohen se sa që kthehen. Kjo brengë duhet të diskutohet në mes të përfaqësuesve të ndryshëm dhe komunitetit Serb të Kosovës si dhe në mekanizmat e kthimit.

Në mënyrë që të mbështetet përparimi tashmë i arritur, është me rëndësi që të zhvillohen masat konkrete për ndërtimin e besimit:

1. Serbët e Kosovës kanë dëshirë që të kenë fonde për të renovuar lokalet e Radio Fokusit, radio stacioni Serb. Kjo kërkesë është aprovuar në nëntor të vitit 2004 mirëpo nuk është implementuar për shkak të mungesës së fondeve komunale. Sipas OSBE-së, radio stacioni është zhvendosur në lokale të reja dhe ka pranuar pasuri të reja. Megjithatë, kërkesa e paplotësuar vazhdon të jetë simbolike për përfaqësuesit serb. Është me rëndësi të përcaktohet nëse radio stacioni ende kërkon fonde; për çfarë qëllime do të përdoren; dhe si mund të plotësohen më së miri këto nevoja. Ky do të ishte një projekt i mundshëm ku mund të punonin të dyja palët, dhe CSSP është e gatshme që të kërkojë donator për një projekt që do të zhvillohej bashkarisht.

2. Duket se ekziston një mosmarrëveshje ndërmjet përfaqësuesve serb dhe atyre shqiptare lidhur me atë sesi të shfrytëzohet më së miri ndihma gjuhësore ekzistuese. Përfaqësuesit Serb kanë kërkuar një përkthyes shtesë, gjë që është aprovuar në buxhetin e vitit 2005. Mirëpo, kjo nuk ishte vënë në zbatim pasi që komuna ka marrë një urdhër që i ndalon të punësojë punëtorë të rinj. Duke pasur parasysh faktin se është vetëm një përkthyes zyrtar i gjuhës serbe kjo çështje duhet të rishqyrtohet. Komiteti i Komuniteteve duhet të bëjë një rishqyrtim të përbashkët të shërbimeve aktuale gjuhësore dhe të bëjë rekomandime që do të ishin të kënaqshme për të gjitha palët, duke marrë parasysh të gjitha çështjet ligjore dhe përgjegjësitë fiskale.
3. Komuna ka bërë përpjekje të mira në drejtim të shfrytëzimit të të dy gjuhëve në të gjitha institucionet dhe dokumentet. Udhëheqësit komunal u garantojnë të gjitha palëve që kanë urdhëruar përdorimin e plotë të dygjuhësisë. Mirëpo, ekzistojnë disa ankesa që urdhëresat komunale nuk zbatohen në tërësi. Është me rëndësi që komuna të forcojë përpjekjet e saj dhe të përkujdeset që kjo çështje të respektohet në tërësi. Kryeshefi Ekzekutiv është i përkushtuar të hetojë këtë çështje dhe çfarëdo shkelje. Ai u dakordua t'i pranoj ankesat me shkrim lidhur me këtë çështje. Ai më tej është pajtuar që kjo çështje do të zgjidhet deri në fund të vitit 2005.
4. Në tavolinën e negociatave të gjitha palët janë pajtuar që bizneset private të inkurajohen në avancimin e përdorimit të të dyja gjuhëve. Sipas OSBE-së, ekziston një iniciativë e financuar në këtë drejtim, e cila duhet të mbështetet dhe të forcohet. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete vërtetoi se komiteti është duke punuar në këtë projekt dhe se ai do të jetë me i dukshëm në të ardhmen. CSSP beson se stimulimet nga sektori privat janë kyçe për përparimin e mëtejshëm në mënyrë që qendra e qytetit të bëhet më tërheqëse për të gjithë qytetarët e komunës. Të gjitha përpjekjet në këtë drejtim duhet të mbështeten nga komuna.
5. Të gjitha palët pajtohen që rregullimi i varrezave të Serbëve dhe ruajtja e tyre si një kompleks kulturor është një masë e rëndësishme në ndërtimin e besimit. Të gjitha palët duhet ta mbështesin këtë përpjekje. CSSP është e gatshme të ndihmojë në gjetjen e donatorëve ndërkombëtare nëse është nevojë dhe nëse palët pajtohen se si të ecin përpara.
6. Projekte shoqërore dhe kulturore shkëmbyese u ofrojnë raste të dyja palëve që të folin me njëri tjetrën jo zyrtarisht. Janë disa shembuj shumë të mirë sic është Qendra Rinore dhe Qendra e Grave, si dhe disa manifestime njëditore nga disa OJQ. Është me rëndësi të zhvillohen kësi lloj ngjarjesh dhe nismash ashtu që këto të bëhen pjesë të jetës së përditshme të komunës.
7. Përfaqësuesit e Serbëve do të cmonin nëse Kryetari i Komunës dhe pjesëtarët e tjerë të qeverisë së komunës do të vizitonin komunitetin e tyre më shpesh. Poashtu, do të ishte mirë nëse Kryetari dhe Nënkryetari Shtesë i vizitojnë të gjitha fshatrat e komunës bashkarisht.

8. Çështja e riposedimit të pronës është shumë e rëndësishme për të drejtat e njeriut. bashkësia serbe ka dorëzuar një listë prej 15 rasteve të pronave që ata besojnë janë zënë ilegalisht. Mirëpo, mekanizmat që janë në dispozicion për shtjellimin e kësaj çështjeje janë të dobët, të pabesueshëm dhe madje edhe shihen si të njëanshëm. Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet që këto raste të zgjidhen në mënyrë transparente e zyrtare ndërsa organizatat ndërkombëtare të ndihmojnë në këtë drejtim. OSBE-ja ka deklaruar më herët se është e gatshme të ndihmojë në mundësimin e takimit ndërmjet Drejtorit Rajonal të Drejtoratit për Çështje Banëso-Pronësore. Zyrtari i Bashkësisë Lokale në Hocë të Madhe, i cili e ka ngritur këtë çështje në takimin e ndërmjetësimit, duhet të kontaktojë OSBE-në dhe DCB-në për këtë çështje.
9. Udhëheqësit e Serbëve të Kosovës janë ankuar për një gjykim që ka ndodhur kohëve të fundit që ka pasur të bëjë me plackitjen e materialit ndërtimor të një Sërbi se rasti ka qenë i manipuluar dhe nuk ka pasur drejtësi. Ata duhet ti kërkojnë monitoruesit të gjykatave pranë OSBE-së në Prizren ta hetojë këtë rast.
10. Komitetet për Ndërmjetësim dhe Komunitete janë shumë të rëndësishëm për funksionimin e vetqeverisjes lokale. Komiteti për Komunitete ka bërë përpjekje të mira. Fatkeqësisht Komiteti për Ndërmjetësim nuk ka arritur nivelin e punës që dëshirohet nga të gjithë pjesëmarrësit. CSSP do të ftojë anëtarët e të dyja komiteteve si dhe udhëheqësit kyc të komuniteteve në një seminar për negociata dhe për zgjidhjen e problemeve.
11. CSSP e mirëpret një raport nga udhëheqësit e komunës për përparimin që është bërë në këto çështje deri në fund të vitit.

Pjesëmarrësit:

|                                 |  |
|---------------------------------|--|
| Z. Esad Haxhijaha               | Kryetar i Komunës  |
| Z. Slavisa Kolasinac            | Nëpunës Komunal për Kthim                                  |
| Z. Zoran Grkovic                | Kryetar i Komitetit për Komunitete                         |
| Z. Dejan Baljosevic             | Nëpunësi Lokal i Komuniteteve                              |
| Z. Jovan Đuričić                | Nëpunësi Komunal për Komunitete                            |
| Z. Nahit Elshani                |  |
| Mr. Ljubiša Đuričić             | Zëvendës Kryetari Shtesë                                   |
| Z. Ibrahim Kryeziu              | Kryeshefi I Egzekutivit                                    |
| Z. Minstote Kosnev              |  |
| Z. Dragan Kukurekovic           | Këshilltar i Ministrit, Ministria për Kthim dhe Komunitete |
| Z. Albert Zeca                  | Zëvendës Këshilltar, Ministria për Kthim dhe Komunitete    |
| Dr. Christian Schwarz-Schilling | Ndërmjetësuesi Kryesor, CSSP                               |
| Dr. Juan Diaz                   | Ndërmjetësues, Bashkëpunëtor, CSSP                         |
| Dr. Dieter Wolkewitz            | Ndërmjetësues, Bashkëpunëtor, CSSP                         |
| Eva Malisius                    | Ndërmjetësues i ri, CSSP                                   |